

# SPAK

## monitor

### PËRMBAJTJA

- *Dy hapa para, një hap mbrapa: Me përfundimin e vetting-ut për anëtarët e KLGJ dhe KLP ngritja e Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe SPAK duket më afër se kurrë. Por a mbaron këtu?*
- *Procesi i ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë: Finalizimi i rivlerësimit të kandidatëve për organet e reja të drejtësisë.*
- *Përzgjedhja e anëtarëve gjyqësorë dhe prokurorë në KLGJ dhe KLP: Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve dhe Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve.*
- *Numri i lartë i ankimeve, problematik për ecurinë e mëtejshme të ngritjes dhe funksionimit të KLGJ dhe KLP: Si mund të sjellë vlerësimi i mundshëm negativ i KPA kthimin e procesit mbrapa.*
- *Niveli minimal në vlerësimin profesional të kandidatëve të konfirmuar për KLGJ dhe KLP një ndër një pikat e dobëta të cilësisë së procesit.*
- *Hapat kyç për fillimin e procesit të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK: Roli i KLGJ-së në ngritjen e Gjykatave të Posaçme dhe KLP-së në ngritjen e Prokurorisë së Posaçme.*

**SPAK Monitor** është një përjekje e shoqërisë civile për të monitoruar, vlerësuar dhe informuar mbi krijimin e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK, si dhe për të sjellë këndvështrime dhe propozime që ndihmojnë në ecjen përpara të këtij procesi.

Ky numër i dytë i SPAK Monitor i dedikohet finalizimit të procesit të ngritjes së Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe SPAK.

Ndërkohë që procesi i vetting-ut për kandidatët për në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka mbaruar, ose të paktën mund të konsiderohet i mbaruar nëse numri i lartë i ankimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nuk do të sjellë përjashtimin e kandidatëve tashmë të miratuar, Mbledhjet e Përgjithshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të sjellin krijimin e këtyre dy organeve kyçe të qeverisjes së sistemit gjyqësor. Megjithatë, procesi i ngritjes së Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe SPAK do të kalojë nëpërmjet procedurave dhe hallkave të tjera siç janë rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të Posaçëm dhe familjarëve të tyre dhe më pas emërimi i tyre.

## Dy hapa para, një hap mbrapa: Me përfundimin e vetting-ut për anëtarët e KLGJ dhe KLP ngritja e Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe SPAK duket më afër se kurrë. Por a mbaron këtu?

Reforma në sistemin e drejtësisë, e cila ka hyrë në vitin e dytë të zbatimit, që nga miratimi i ndryshimeve kushtetuese në korrik 2016, pritet të sjellë gjatë muajit dhjetor 2018 krijimin e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe fillimin e ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme.

Përveç shortimit për kandidatët në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED), ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) përbën një nga zhvillimet më thelbësore të ecurisë së deritanishme të reformës.

Krijimi i KLGJ dhe KLP është një hap deziziv jo vetëm për administrimin dhe menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, por edhe për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme dhe prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme.

Për të bërë të mundur krijimin më së pari të këtyre dy këshillave, rivlerësimi i subjekteve të listës prioritare, kandidatë për këto organe, ka qenë fokusi kryesor i procesit të deritanishëm të vetting-ut. Megjithëse ky proces u shoqërua me ritme të ngadalta dhe shkëputje të konsiderueshme kohore ndërmjet seancave dëgjimore, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) përfundoi rivlerësimin për kandidatët e fundit në këto organe gjatë muajit nëntor, pas një periudhe 8 mujore.

Por megjithë prioritarizimin për të realizuar vetting-un për kandidatët për këto dy këshilla, rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve akoma nuk mund të konsiderohet i përfunduar, çka mund të ketë ndikim jo vetëm në ecurinë e mëtejshme të procesit të ngritjes të vetë dy organeve në fjalë, por edhe të ngritjes së Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe SPAK. Kjo për shkak të numrit të lartë të ankimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA), të cilat mund të sjellin përjashtimin e kandidatëve nga KLGJ apo KLP edhe pas zgjedhjes së tyre nga Mbledhjet e Përgjithshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ndërkohë që zgjedhja e anëtarëve për KLGJ dhe KLP pritet të përfundojë gjatë muajit dhjetor, ushtrimi i kompetencave të tyre në drejtëm të emërimit të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme dhe prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme nuk do të jetë një proces me efekt të menjehershëm. Të gjithë subjektet kandidatë për Gjykatat dhe Prokurorinë e Posaçme do të duhet që fillimisht të konfirmohen në detyrë nëpërmjet rivlerësimit nga KPK. Nëpërmjet procesit të rivlerësimit, KPK do të vijojë me kontrollin e familjarëve të afërt të këtyre subjekteve dhe në konsideratë të praktikës së deritanishme me listën e përparësisë, edhe ky proces do të marrë kohën e nevojshme për t'u kryer.

Duke patur si fokus monitorimin e ngritjes së Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, në këtë numër të dytë SPAK Monitor trajton procesin e ngritjes së KLGJ dhe KLP në funksion të rolit të tyre në ngritjen e këtyre organeve. Ky proces përfshin finalizimin e rivlerësimit për kandidatët e këtyre organeve dhe zgjedhjen e tyre nga Mbledhjet e Përgjithshme përkatëse.

Në këtë numër trajtohen gjithashtu disa nga çështjet kryesore të shfaqura pas përfundimit të rivlerësimit të kandidatëve për KLGJ dhe KLP, siç janë numri i lartë i ankimeve dhe numri i lartë i kandidatëve me vlerësim minimal në kriterin profesional. Këto çështje elaborohen me qëllim për të sjellë në vëmendje ndikimin që ato mund të kenë në vijim për ecurinë e mëtejshme të procesit të krijimit të institucioneve kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Së fundmi, rivlerësimi i kandidatëve gjyqtarë dhe prokurorë për Gjykatat dhe Strukturën e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përshkruhet si një ndër hapat kryesorë dhe përcaktues për fillimin e ngritjes së këtyre institucioneve.

*Ngritja e Gjykatave dhe Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (SPAK) është parashikuar të fillojë me krijimin e KLGJ dhe KLP, kjo pasi këto dy organe janë përgjegjëse për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK.*

*Me përfundimin e rivlerësimit të kandidatëve për KLGJ dhe KLP, Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë caktuar datat për Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga të cilat brenda një afati 20 ditor do të zgjidhen anëtarët e rinj duke sjellë krijimin e dy organeve.*

*Megjithatë numri i lartë i ankimeve për kandidatët e konfirmuar në KLGJ dhe KLP dhe mundësia e vlerësimit negativ nga KPA mund të krijojnë vonesa të reja. Ndërkohë që edhe në rastin e konfirmimit përfundimtar nga KPA të gjyqtarëve dhe prokurorëve anëtarë të KLGJ dhe KLP, për shkak të rivlerësimit të detyrueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve kandidatë në Gjykatat dhe Strukturën e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ngritja e këtyre strukturave nuk mund të kryhet në mënyrë të menjëhershme.*

# Procesi i ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë: Finalizimi i procesit të rivlerësimit të kandidatëve për organet e reja të drejtësisë

Në listën për subjektet e përparësitë të muajit dhjetor 2017 u renditën në total 32 kandidatë për të dy Këshillat: 14 kandidatë gjyqtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe 18 kandidatë prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP). Megjithëse procesi i rivlerësimit të këtyre subjekteve pritej të zhvillohej me ritme të përspejtuara, me qëllim ecjen më shpejtë drejt ngritjes së organeve të drejtësisë, zhvillimi i seancave dëgjimore u shoqërua me ritme të ulta dhe shpesh kohore. Muaji korrik, ishte muaji i vetëm, i cili shënoi numrin më të madh të seancave dëgjimore, ndërkohë që gjatë muajve mars dhe tetor

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) nuk shqyrtoi asnjë nga subjektet kandidatë për KLGJ apo KLP.

Zgjatja e procesit të rivlerësimit ndodhi edhe si pasojë e moskonfirmimit të disa subjekteve, duke shpënë për pasojë në mosplotësimin e numrit të nevojshëm të subjekteve për pozicionet respektive. Thirrjet për këta kandidatë u rishpallën dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme si nga Gjykata e Lartë ashtu edhe nga Prokuroria e Përgjithshme. Vetëm në shtator dhe në fund të muajit tetor këto institucione shpallën kandidatët e rinj për KLGJ dhe KLP.

Pas një periudhe 8 mujore (mars-

nëntor), rivlerësimi për të gjithë këta subjekte arriti të përmbyllej në datën 23 nëntor 2018, me zhvillimin e seancave dëgjimore për kandidatët e fundit në KLGJ dhe KLP. Vendimet e Komisionit konfirmuan në detyrë 10 nga 16 kandidatët për KLGJ dhe 10 nga 19 kandidatët për KLP. Nga të gjitha vendimet e dhëna për këto subjekte 17 janë ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA). Ndërkohë mbetet problematik numri relativisht i lartë i ankimeve për kandidatët e konfirmuar (35%), pasi përveç KPK-së këto subjekte duhet të konfirmohen edhe nga KPA.

## Lista përfundimtare e kandidatëve të konfirmuar nga KPK

<b>Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)</b>
3 gjyqtarë të shkallës së parë (≥1 jashtë Tiranës)
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Alma Brati</li><li>2. Astrit Faqolli</li><li>3. Brunilda Kadi</li><li>4. Dritan Hallunaj</li><li>5. Manjola Xhaxho</li><li>6. Marçela Shehu (Kurbini)</li></ol>
2 gjyqtarë të gjykatës së apelit (≥1 jashtë Tiranës)
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ilir Toska</li><li>2. Nertina Kosova</li><li>3. Brikena Ukperaj (Vlorë)</li></ol>
1 gjyqtar nga Gjykata e Lartë
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Medi Bici</li></ol>

<b>Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)</b>
3 prokurorë të shkallës së parë (≥1 jashtë Tiranës)
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Antoneta Sevdari</li><li>2. Besnik Muçi</li><li>3. Gentjan Osmani</li><li>4. Dritan Prençi (Kukës)</li><li>5. Vat Staka (Shkodër)</li><li>6. Besnik Cani (Elbasan)</li></ol>
2 prokurorë pranë gjykatës së apelit (≥1 jashtë Tiranës)
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Bujar Sheshi</li><li>2. Arben Dollapaj (Shkodër)</li></ol>
1 prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Anila Leka</li><li>2. Kostaq Beluri</li></ol>

# Përzgjedhja e anëtarëve gjyqtarë dhe prokurorë në KLGJ dhe KLP:

## Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve dhe Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve

Zgjedhja përfundimtare e kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) nuk përfundon vetëm me konfirmimin e tyre në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë parashikon edhe disa hapa të tjerë ligjorë, të cilët përfundojnë me zhvillimin e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve dhe Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve.

Më specifikisht, me përfundimin e rivlerësimit për kandidatët e dy Këshillave, Komisioni i Pavarur i

Kualifikimit jo më vonë se 3 ditë pas përfundimit të procedurës së rivlerësimit, duhet ti përcjellë Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm listën me emrat e kandidatëve gjyqtarë dhe prokurorë që kanë kaluar me sukses procedurën e rivlerësimit. Ndërkohë, brenda po 3 ditëve nga data e mbërritjes së listës nga KPK, Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve dhe Prokurori i Përgjithshëm Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve është parashikuar të përfundojë brenda 20 ditëve nga data

e thirrjes së Mbledhjeve respektive. Aktualisht të dyja institucionet kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare datën e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të caktuara respektivisht në datat 12 dhe 11 dhjetor 2018. Në kushtet kur, procedura e përzgjedhjes përfundimtare për kandidatët e konfirmuar për anëtarë gjyqtarë në KLGJ dhe anëtarë prokurorë në KLP duhet të finalizohet brenda 20 ditëve, ngritja e këtyre organeve përfundon brenda vitit 2018.

### Procedura e zgjedhjes së anëtarëve për KLGJ dhe KLP

### Afati ligjor

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e gjyqtarëve/prokurorëve që kandidojnë pas dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit

Seanca e fundit (23.11.2018)  
Vendimi i fundit (27.11.2018)

Komisioni i Pavarur i Rivlerësimit i përcjell Kryetarit të Gjykatës së Lartë listën me emrat e kandidatëve gjyqtarë që e kaluan me sukses procedurën e rivlerësimit.

27 Nëntor 2018

Komisioni i Pavarur i Rivlerësimit i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm listën me emrat e kandidatëve prokurorë që e kaluan me sukses procedurën e rivlerësimit.

27 Nëntor 2018

Pas marrjes së listës nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve.

12 Dhjetor 2018

Pas marrjes së listës nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Prokurori i Përgjithshëm thërret Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve.

11 Dhjetor 2018

Përfundon procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë të KLGJ dhe prokurorëve për KLP

Brenda 20 ditëve

# Numri i lartë i ankimimeve, problematik për ecurinë e mëtejshme të ngritjes dhe funksionimit të KLGJ dhe KLP: Si mund të sjellë vlerësimi i mundshëm negativ i KPA kthimin e procesit mbrapa

Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve dhe Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve pritet të zgjedhin në datat 11 dhe 12 dhjetor anëtarët e parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP). Megjithëse zgjedhja e tyre sjell krijimin e shumëpritur të këtyre organeve, për ato anëtarë vendimet e të cilëve janë ankimuar, duhet të vendosë në mënyrë përfundimtare edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA).

Duke qenë se gati një e treta e vendimeve (7 nga 20) të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kandidatët e konfirmuar në KLGJ dhe KLP është apeluar në KPA, përcaktues për këto subjekte do të jetë vendimi i këtij të fundit. Në të dyja rastet, kur subjektet janë shkarkuar nga Komisioni dhe janë konfirmuar nga Kolegji, apo kur janë konfirmuar nga Komisioni dhe janë

shkarkuar nga Kolegji, ligji për rivlerësimin nuk lejon vazhdimin e konkurrimit të kandidatëve për të qenë pjesë e KLGJ apo KLP.

Pavarësisht se deri tani, KPA ka lënë në fuqi pjesën më të madhe të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri i konsiderueshëm i ankimimeve në raport me numrin e kandidatëve të konfirmuar për KLGJ dhe KLP, përbën një fazë mjaft delikate të procesit.

Moskonfirmi në detyrë nga Kolegji i Apelit i kandidatëve të konfirmuar dhe të zgjedhur parashikohet të sjellë mosplotësim të numrit të pozicioneve dhe rifillimin e shpalljeve dhe procedurave për aplikimin e kandidatëve të rinj. Në të njëjtën kohë ky proces teknik do të duhet të parashikojë gjithashtu edhe procedurën e rivlerësimit në raset kur kandidatët nuk i janë nështruar ende këtij procesi.



Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)	Kandidatët përfundimtarë të konfirmuar nga KPK	Vendimet e ankimuara në KPA për kandidatët e konfirmuar	
		Apeluar nga:	Statusi
Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)	3 gjyqtar të shkallës së parë (≥1 jashtë Tiranës)		
	1. Alma Brati	→ Komisioneri Publik	Përgatitje për gjykim
	2. Astrit Faqolli	→ Komisioneri Publik	
	3. Brunilda Kadi		
	4. Dritan Hallunaj		
	5. Manjola Xhaxho		
	6. Marçela Shehu (Kurbini)		
	2 gjyqtarë të gjykatës së apelit (≥1 jashtë Tiranës)		
	1. Ilir Toska		
	2. Nertina Kosova	→ Komisioneri Publik	Përgatitje për gjykim
	3. Brikena Ukperaj (Vlorë)		
	1 gjyqtar nga Gjykata e Lartë		
	1. Medi Bici		

Numri i ankimeve nga kandidatët e konfirmuar për Këshillin e Lartë të Prokurorisë gjithashtu rrezikon ta bëjë të paparashikueshëm vijimin e ngritjes së këtij Këshilli, pasi Komisioneri Publik ka ankimuar në KPA të tre kandidatët e konfirmuar për prokurorë të shkallës së parë. Moskonfirmimi nga KPA i vetëm 2 prej tyre do të sillte rishpallje

të procedurës për konkurrim. Ndërkohë, edhe për pozicionin e prokurorëve që vijnë nga gjykatat e apelit, vendimi për prokurorin e vetëm nga gjykatat e apelit jashtë Tiranës është ankimuar në KPA. Në kushtet kur vetëm ky kandidat ka kaluar fazën e parë për këtë pozicion, vendimi i KPA pritet të jetë gjithashtu përcaktues për

vijimësinë e ngritjes së KLP. Nëse në të dyja këto raste do të ketë rishpallje të thirrjeve, krijimi i KLP do të jetë i pamundur të realizohet, duke e rikthyer procesin mbrapa në kohë dhe duke sjellë përsëritje të procedurave dhe zgjatje të kohës për krijimin e këtij organi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)	Kandidatët përfundimtarë të konfirmuar nga KPK	Vendimet e ankimuara në KPA për kandidatët e konfirmuar	
		Apeluar nga:	Statusi
	3 prokurorë të shkallës së parë (≥1 jashtë Tiranës)		
	1. Antoneta Sevdari	→ Komisioneri Publik	Përgatitje për gjykim
	2. Besnik Muçi	→ Komisioneri Publik	Përgatitje për gjykim
	3. Gentjan Osmani	→ Komisioneri Publik	Përgatitje për gjykim
	4. Dritan Prençi (Kukës)		
	5. Vat Staka (Shkodër)		
	6. Besnik Cani (Elbasan)		
	2 prokurorë të prokurorive të apelit (≥1 jashtë Tiranës)		
	1. Bujar Sheshi		
	2. Arben Dollapaj (Shkodër)	→ Komisioneri Publik	Përgatitje për gjykim
	1 prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme		
	1. Anila Leka		
	2. Kostaq Beluri		

Ndërkohë publikimi i vendimeve të KPK-së 30 ditë nga njoftimi i tyre është një faktor i rëndësishëm për depozitimimin në kohë të ankimeve të mundshme nga Komisioneri Publik apo vetë subjektet, të cilët mund ti drejtohen KPA-së brenda 15 ditëve nga data e njoftimi të vendimit të KPK-së. Derit tani publikimi i vendimeve për 13 kandidatë në KLGJ dhe KLP ka tejkalluar afatet ligjore, duke krijuar vonesa në procesin e ankimeve dhe në procesin e rivlerësimit në tërësi.



# Niveli minimal në vlerësimin profesional të kandidatëve të konfirmuar për KLGJ dhe KLP një ndër një pikat e dobëta të cilësisë së procesit

Kandidatët, të cilët kanë marrë tashmë konfirmimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të qenë anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) pritet të luajnë një rol tepër të rëndësishëm për shkak të kompetencave që do të kenë kundrejt gjyqësorit apo prokurorisë si edhe emërimeve në Gjykatat e Posaçme dhe Prokurorinë e Posaçme.

Për këtë arsye, kriteret profesionale të kandidatëve janë mjaft të rëndësishme për përzgjedhjen e tyre. Edhe më herët, gjatë përzgjedhjes së anëtarëve jo-gjyqësorë dhe jo-prokurorë, mosplotësimi i kriterëve profesionale ka shpënë në rishpalljen e thirrjeve për aplikime deri në 6 herë, dhe si pasojë shtyrje të afateve


kohore dhe vonesa në ngritjen e KLGJ dhe KLP.

Pavarësisht standardeve fillestare për aplikim, të vendosura në dispozitat ligjore për anëtarët gjyqësorë dhe prokurorë, ligji për rivlerësimin lejon konfirmimin në detyrë të subjekteve edhe me një vlerësim minimal të aftësive profesionale, krahasuar me dy kriteret e tjera të pasurisë dhe figurës.

Aktualisht bazuar në vendimet e publikuara, 35% e subjekteve gjyqësorë dhe prokurorë kandidatë për KLGJ dhe KLP të cilët tashmë janë konfirmuar në detyrë, janë vlerësuar me nivelin minimal kualifikues për sa i përket kriterit të aftësive profesionale.

Ndërkohë që për anëtarët e Gjykatave të Posaçme dhe Strukturës së Posaçme Anti-korrupsion SPAK profesionalizmi konsiderohet ndër elementët thelbësorë për emërimin e tyre, kjo tendencë në lidhje me profesionalizmin e antarëve të KLGJ-së dhe KLP-së përbën një ndër pikat e dobëta të cilësisë së procesit. Në funksion të rolit dhe kompetencave që do të kenë anëtarët e KLGJ dhe KLP, kontrolli profesional i tyre duhet të konsiderohet i pandashëm nga kriteret e tjera, me qëllim që për këto subjekte të ketë një vlerësim sa më gjithëpërfshirës dhe të plotë.

Niveli i vlerësimit profesional për kandidatët e konfirmuar në KLGJ dhe KLP




# Hapat kyç për fillimin e procesit të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK: Roli i KLGJ-së në ngritjen e Gjykatave të Posaçme dhe KLP-së në ngritjen e Prokurorisë së Posaçme

Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) janë hallka mjaft të rëndësishme në procesin e ngritjes së Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK. Të dy këto organe kanë të parashikuara kompetenca specifike të cilat lidhen me emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme dhe prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme. Megjithatë, ushtrimi i këtyre kompetencave dhe ngritja e institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përbën një proces kompleks, i cili parashikon një sërë hapash të ndërmjetëm dhe procedurash të parashikuara në legjislacion. Vetëm

me zbatimin e tyre ngritja dhe vënia në funksionim e institucioneve të reja kundër korrupsionit mund të konsiderohet e kryer. Një nga komponentët kryesorë të këtij procesi ka të bëjë me rivlerësimin e subjekteve që do të kandidojnë për këto institucione. Siç është përmendur edhe më sipër, konfirmimi në detyrë i gjyqtarëve dhe prokurorëve është një hap i detyrueshëm për ushtrimin e funksioneve të tyre. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) përfundoi në nëntor 2018 rivlerësimin me përparësi për kandidatët në KLGJ dhe KLP, të cilët do të zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me zgjedhjen e tyre

dhe ngritjen e KLGJ dhe KLP, kandidatët gjyqtarë në Gjykatat e Posaçme dhe kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme do të duhet të rivlerësohen gjithashtu nga KPK për të bërë të mundur emërimin e tyre nga KLGJ dhe KLP dhe për ti hapur rrugë fillimit të ngritjes së këtyre institucioneve. Edhe pse përfundimi i rivlerësimit për kandidatët në KLGJ dhe KLP mori 8 muaj kohë, dhe duke qenë se procesi u përball me një numër të lartë të ankimeve dhe mosplotësim të vendeve vakante, procesi i ngritjes së institucioneve anti-korrupsion parashikohet të kalojë nëpërmjet procesesh të tjera.



**KY BULETIN REALIZOHET NË KUADËR TË PROJEKTIT: FORCIMI I INFORMIMIT DHE PJESMARRJES SË PUBLIKUT NË ZBATIMIN E REFORMËS NË DREJTËSI NËPËRMJET MONITORIMIT, VLERËSIMIT DHE KOMUNIKIMIT TË PROCESIT TË NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

*Projekt i financuar nga:*

*Fondacioni*

*Shoqëria e Hapur për Shqipërinë*

Gjatë periudhës Qershor 2018 – Korrik 2019 Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) do të punojë për zbatimin e projektit të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë “ Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Reforma në sistemin e drejtësisë është një nga reformat më të thella dhe gjithëpërfshirësë të ndërmarra në Shqipëri në vitet e fundit, e cila synon të adresojë problemin e hetimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të evidentuara ndër pengesat kryesore për zhvillimin e metejshëm ekonomik shoqëror të vendit dhe për antarësimin në Bashkimin Evropian. Një nga komponentët kryesorë të kësaj reforme është ngritja e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

**INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN**



<b>Kohëzgjatja</b>	Qershor 2018 – Korrik 2019
<b>Programi/ Fusha e zbatimit</b>	Programi i Reformës në Drejtësi financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
<b>Nevoja e zbatimit të këtij Projekti</b>	Vonesat e shkaktuara në ngritjen e institucioneve të vetting-ut dhe vëzhguesia për të ndjekur dhe kuptuar aspektet teknike të procesit.
<b>Qëllimi i Projektit</b>	Qëllimi kryesor i projektit është rritja e cilësisë së informimit mbi reformën në drejtësi dhe mbështetjes së kuptueshmërisë së qytetarëve dhe aktorëve shoqërorë përsa i përket zbatimit të reformës.
<b>Objektivat e Projektit</b>	Objektivat specifikë të projektit janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>· Të monitorojë dhe vlerësojë procesin e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;</li> <li>· Të inkurajojë dhe nxisë diskutimin dhe pjesmarrjen e mirëinformuar të qytetarëve dhe aktorëve shoqërorë në procesin e krijimit dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;</li> <li>· Të advokojë dhe mbështesë autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e reformës në drejtësi.</li> </ul>
<b>Instrumentat dhe mekanizmat</b>	Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet <b>(1) monitorimit, (2) vlerësimit dhe (3) komunikimit</b> të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.
<b>Institucionet e reformës në drejtësi, fokusi i Projektit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar</li> <li>· Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar</li> <li>· SPAK një strukturë e cila përbëhet nga dy komponentë: <ul style="list-style-type: none"> <li>· Prokuroria e Posaçme</li> <li>· Byroja Kombëtare e Hetimit</li> </ul> </li> </ul>
<b>Produktet e Projektit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Gjenerimi i dy raporteve hulumtuese</li> <li>· Përgatitja e katër buletineve informuese, një në çdo tre muaj, nën titullin “SPAK Monitor”</li> <li>· Një Raport përfundimtar I projektit</li> <li>· Publikimi i dymbëdhjetë artikujve në media të bazuar në gjetje nga hulumtimi</li> <li>· Përgatitja dhe shpërndarja e dy spoteve audiovizuale sensibilizuese e informuese</li> <li>· Dy tryeza të rrumbullakta me pjesmarrjen e palëve të interesuara</li> <li>· Një konferencë përfundimtare</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Rezultatet e pritshme të projektit janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>· Përmirësimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në proces;</li> <li>· Përmirësimi i ecurisë dhe cilësisë së procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;</li> <li>· Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit, mbikqyrjes dhe llogaridhënies dhe në tërësi një ecuri më e mirë e procesit të zbatimit të reformës në drejtësi.</li> </ul>
<b>Përfituesit kryesorë</b>	Përfituesit kryesorë të projektit do të jenë: <ul style="list-style-type: none"> <li>· Publiku i gjerë, i cili do të ketë një shkallë më të lartë informimi dhe pjesmarrje dhe për pasojë ndikim mbi procesin;</li> <li>· Organizatat e mediave dhe gazetarë, të cilat do të rrisin cilësinë dhe shpeshësinë e informimit mbi krijimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe funksionimin në periudhën e hershme të tyre;</li> <li>· Organizatat e shoqërisë civile, të cilat do të forcojnë rolin dhe ndikimin e tyre monitorues dhe mbikëqyrës,</li> <li>· Institucionet politikëbërëse dhe ligjzbatuese, të cilat do të kenë legjitimitet të shtuar si rezultat i ndërveprimit më të hapur me publikun dhe aktorët shoqërorë në tërësi.</li> </ul>